


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6205
E martë, 5 janar 2021
çmimi 0.40 €

FSK-së i bëhet ftesë
në misionin e parë
jashtë vendit FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ANALISTËT POLITIKË FLASIN PËR PRITJET QË KANË PËR VITIN 2021 FAQE 4-5

KËTË VIT KOSOVËS I DUHET UNITET POLITIK



Njohësit e rrethanave politike në vend shpresojnë se viti 2021 nuk do të jetë i njëjtë për Kosovën si viti që lamë pas. Ata kanë bërë me dije se spektri politik duhet të reflektojë për

disa çështje me rëndësi të madhe për vendin. Sipas tyre, partitë politike duhet të gjejnë një konsensus nacional, sidomos për procesin e dialogut me Serbinë.

Analistët kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se sfida kryesore me të cilën do të përballen institucionet e vendit pas zgjedhjeve do të jetë dialogu Kosovë - Serbi


OPINION

DISA PIKA TË NJË PROGRAMI
EVENTUAL POLITIK NDAJ
SERBISË F. 11

Milazim
KRASNIQI



AKTUALE



MASAT ANTI-COVID, PËR TRI
DITË POLICIA SHQIPTOI 908
GJOBA F. 6

LLADROVCI SFIDON PARTITË
E TJERA: KUNDËR 30
KANDIDATËVE FITOJ VEÇ VETË F. 6

EKONOMI

RRITET BASHKËPUNIMI NË
TURIZËM NË MES TË
AGJENCIVE TË SHQIPËRISË
DHE TË KOSOVËS F. 8

VITI I RIKUPERIMIT TË DËMEVE
TË PANDEMISË F. 8

KULTURË

MONUMENTI LETRAR
SKËNDERBEUT F. 11



Prof. Shaip EMËRLLAHU

BIEN RASTET E TË INFEKTUARVE ME COVID NË KOSOVË

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë konfirmuar edhe 169 raste të reja me Covid-19. Ky virus ua ka shkaktuar vdekjen edhe shtatë

personave në Kosovë. IKShPK-ja ka njoftuar se viktimat janë nga Mitrovica, Peja, Istogu, Prishtina dhe Prizreni. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar nga Covidi edhe 313 pacientë



AKR-ja PËLQEN KOALICION PARAZGJEDHOR ME LV-NË OSE PDK-në

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Netanyahu thotë se Izraeli nuk do ta lejojë Iranin të prodhojë armë bërthamore

Jerusalemi, 4 janar - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë të hënën se ripërtëritja e pasurimit të uraniumit nga Irani dëshmon se ky vend po synon të prodhojë armë bërthamore, pavarësisht se e mohon këtë.

Të hënën Irani rifilloi pasurimin e uraniumit në 20 për qind, gjë që paraqet shkeljen më të madhe të marrëveshjes bërthamore të vitit 2015 me fuqitë botërore. Zëdhënësi i qeverisë iraniane, Ali Rabiei, tha për mediat lokale se procesi ka nisur në uzinën nëntokësore Fordow.

Netanyahu në një deklaratë ka pohuar se ky veprim "nuk



mund të shpjegohet në asnjë mënyrë, përveç si realizim i vazhdueshëm i qëllimit të Iranit për të zhvilluar një program ushtarak bërthamor". "Izraeli nuk do të lejojë Iranin të prodhojë armë bërthamore", shtoi ai.

Izraeli, që besohet gjerësisht se është i vetmi vend që ka armë bërthamore në Lindjen e Mesme, ka pohuar prej kohësh se Teherani po përpiqet ta zhvillojë arsenalin e tij bërthamor dhe se kërkon shkatërrimin e shtetit hebre. Netanyahu ka argumentuar gjatë dhe ashpër kundër marrëveshjes së vitit 2015 midis Iranit dhe fuqive botërore për heqjen e sanksioneve ndërkombëtare ndaj Teheranit. Në vitin 2018, presidenti i ShBA-së, Donald Trump, tërhoqi Shtetet e Bashkuara nga marrëveshja dhe rivendosi sanksionet, duke bërë që Irani t'i tërhiqte zotimet e veta. Por, Bashkimi Evropian dhe

nënshkruesit e tjerë Franca, Britania, Gjermania, Rusia dhe Kina e kanë mbajtur marrëveshjen gjallë.

Bashkimi Evropian paralajmëroi të hënën se lëvizja e Iranit për ta pasuruar uraniumin për 20 për qind do të ishte një "largim i konsiderueshëm" nga angazhimet e Teheranit sipas marrëveshjes bërthamore të vitit 2015.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka theksuar se Brukseli do të presë një konferencë nga drejtori i Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Bërthamore përpara se të vendosë se çfarë veprimi do të ndërmerret.

Qeveria franceze arsyeton vonesat në vaksinim



PARIS, 4 JANAR - Qeveria franceze i ka dalë në mbrojtje fushatës së saj të vaksinimit kundër koronavirusit, përkundër kritikave se ajo po shkon shumë ngadalë. Në javën e parë të fushatës janë vaksinuar 516 persona. Zëdhënësi i qeverisë, Gabriel Attal, tha se vonesat janë shkaktuar për arsye të logjistikës. Sipas tij, ekipet shëndetësore duhej t'i vizitonin të moshuarit në shtëpitë e

kujdesit dhe ta merrnin pëlqimin e secilit person. Nga e diela në mëngjes rreth 240 000 persona ishin vaksinuar në Gjermani.

Britania e Madhe është bërë vendi i parë në botë që filloi t'u japë njerëzve vaksinën kundër koronavirusit të Oksford-AstraZeneca. Ndërsa, në këtë vend rreth një milion njerëz tashmë janë vaksinuar me atë të Pfizer/BioNTech.

Gabriel Attal, i cituar nga faqja franceze e lajmeve LCI, tha se qeveria franceze po ndiqte këshillat shkencore, duke u dhënë përparësi të moshuarve në shtëpitë e kujdesit. Franca është ndër vendet më të goditura të Evropës nga pandemia. Numri i të vdekurve nga Covid-19 deri më tani është 65 037 pak më pak se Italia dhe Mbretëria e Bashkuar. Spitalet franceze po trajtojnë 24 780 pacientë.

Assange nuk ekstradohet në ShBA



LONDËR, 4 JANAR - Themeluesi i uebfaqes WikiLeaks, Julian Assange, nuk mund të ekstradohet në Shtetet e Bashkuara, vendosi të hënën një gjykatë në Londër. Gjykatësja Vanessa Baraitser e bllokoi kërkesën për ekstradim, për shkak të shqetësimeve për shëndetin e tij mendor.


Assange, 49 vjeç, kërkohet për shkak të publikimit të mijëra dokumenteve të klasifikuara të ushtrisë amerikane, më 2010 dhe 2011. ShBA thotë se rrjedhja e atyre dokumenteve në publik, ka thyer ligjin dhe ka rrezikuar jetë njerëzish. Assange e ka luftuar ekstradimin dhe thotë se rasti i tij është i motivuar

politikisht. Autoritetet amerikane thanë se vendimi do të apelohej. Assange është arrestuar në Londër me kërkesë të ShBA-së, pasi është dëbuar nga Ambasada e Ekuadorit, në prill të vitit 2019. Ai është strehuar në ambasadë qysh në vitin 2012, kur Ekuadori i ka dhënë azil politik.

Mbretëria e Bashkuar nis përdorimin e vaksinës Oxford/AstraZeneca

Londër, 4 janar - Në Mbretërinë e Bashkuar nisi të hënën imunizimi kundër koronavirusit me vaksinën Oxford/AstraZeneca. Brian Pinker, 82 vjeç, u bë personi i parë që mori këtë vaksinë në Spitalin Universitar të Oksfordit. Sekretari britanik i Shëndetësisë, Matt Hancock, e përshkroi vaksinën si "një moment shumë i rëndësishëm" në

luftën e Mbretërisë së Bashkuar kundër koronavirusit. Mbretëria e Bashkuar është një nga vendet më të prekura në Evropë, me mbi 2.6 milionë njerëz të infektuar me koronavirus dhe mbi 75 000 viktima. Rregullatorët shëndetësorë britanikë e kanë miratuar vaksinën Oxford/AstraZeneca më 30 dhjetor.



FSK-ja në misionin e parë jashtë vendit

Pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) do të shkojnë në një mision paqeruajtës jashtë vendit. Ministria e Mbrojtjes ka njoftuar se Qeveria e Kosovës ka aprovuar vendimin për bashkëdërgimin e kontingjentit të FSK-së në misionin e parë paqeruajtës jashtë vendit si pjesë e Gardës Kombëtare të Ajovas, sipas ftesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 JANAR - Me kërkesë të Ministrisë së Mbrojtjes, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar vendimin për bashkëdërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë në misionin e parë paqeruajtës jashtë vendit si pjesë e Gardës Kombëtare të Ajovas, sipas ftesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kontingjenti i FSK-së jashtë vendit do të jetë pjesë e misionit për ofrimin e mbështetjes për stabilitet rajonal dhe operacione paqeruajtëse në regjionin e Komandës Qendrore Amerikane - U.S. Central Command (USCENTCOM).

Krahas përkushtimit të vazhdueshëm për t'i avancuar aftësitë dhe kapacitetet operacionale, FSK-ja po arrin suksese të mëdha edhe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar duke fuqizuar në vazhdimësi subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Besimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ta përfshijë FSK-në në misione ndërkombëtare paqeruajtëse, konfirmon edhe një herë përkrahjen për Kosovën duke e konsideruar faktor të rëndësishëm për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon e kudo në

botë. Kosova mbetet e përkushtuar për bashkëpunimin me ShBA-në dhe partnerët strategjikë në orientimet e saj euroatlantike. FSK-ja deri më tani nuk ka marrë pjesë në operacione paqeruajtëse jashtë vendit. Në vitin 2018 Kuvendi i Kosovës ka miratuar ndryshimet ligjore për transformimin e mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në forca të armatosura. Sipas legjislacionit, është paraparë që

procesi i transformimit në Ushtrinë e Kosovës të zgjasë dhjetë vjet.

Në dyvjetorin e zyrtarizimit të mandatit ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), komandanti i kësaj force, gjeneral Rahman Rama, ka thënë se është bërë punë e madhe në planin e tranzicionit. Ai ka thënë se për këto dy vjet ka parametra pozitivë për ecurinë dhe zhvillimin e FSK-së. Gjeneral Rama ka thënë se i kanë tejkaluar pritshmëritë sa i përket realizimit

të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së. Ai ka treguar se faza e parë e tranzicionit të FSK-së pritet të përmbyllet në fillim të këtij viti, për të filluar pastaj me fazën e dytë të tranzicionit që, sipas tij, është më sfiduese dhe më komplekse. "Në këtë fazë do ta fillojmë ngritjen e kapaciteteve me mandat dhe mision të ri duke u bazuar në ligje dhe në obligimet tona kushtetuese për mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit të vendit", ka thënë Rama.



AKR-ja pëlqen koalicion parazgjedhor me LV-në ose PDK-në

**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 4 JANAR - Kryetari i Kuvendit Aleanca Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se kjo parti synon të shkojë në koalicion parazgjedhor në zgjedhjet e parakohshme. Në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se AKR-ja preferon koalicion me partitë opozitare, Lëvizjen Vetëvendosje ose Partinë Demokratike të Kosovës. Megjithatë, ai ka treguar se mundësia ekziston që të ketë bashkëpunim edhe me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Sipas Matoshit, kushti i vetëm i AKR-së për koalicion

do të jetë pajtimi për program dhe për të bërë punë të mira për vendin. "Tani meqenëse jemi në opozitë, do të ishte më e udhës që të jemi me ndonjërin nga partitë opozitare, LV-në ose PDK-në, por mundësia ekziston që të kemi bashkëpunim dhe koalicion edhe me LDK-në", ka thënë Matoshi.

Ai ka theksuar se viti që lamë pas ishte një nga vitet më të vështira që nga paslufta. "Nuk ishte një vit i mirë e i mbarë për Kosovën sikundër që ishte vit shumë i rëndë për gjithë botën për shkak të përhapjes së virusit Covid-19, i cili, pos dëmeve të mëdha e humbjes së jetëve të njerëzve, sollti edhe pasoja të rënda edhe në ekonomi e



zhvillim. Ishte një vit me një pasiguri institucionale, me institucione të brishta. Filluam vitin me një qeveri në detyrë, pastaj vendi u qeveris edhe

rreth dy muaj të pranverës po nga një qeveri në detyrë dhe vitin po e përmbyllim sërish me një qeveri në detyrë, pa president, pa drejtor të AKI-së,

pa drejtor të policisë, pa drejtor të ShSKUK-së në kohë pandemie etj. E gjithë kjo jo për koncepte politike e zhvillimore për vendin, por nga etja dhe dëshira për pushtet më të madh të disa liderëve politikë. Kosova u përballë edhe me Gjykatën Speciale e cila, po ashtu, ishte ngjarje e keqe që na ndodhi. Presidenti i vendit, dy ish-kryeparlamentarë dhe shefi i deputetëve të partisë më të madhe në vend u privuan nga liria dhe detyrat e tyre institucionale që kishin, për t'u përballuar me akuzat e fabrikuar që rëndojnë mbi ta e që ndërlidhen me kohën e luftës çlirimtare", është shprehur Matoshi.



ANALISTËT POLITIKË FLASIN PËR PRITJET QË KANË PËR VITIN 2021

KËTË VIT KOSOVËS I DUHET UNITET POLITIK

Njohësit e rrethanave politike në vend shpresojnë se viti 2021 nuk do të jetë i njëjtë për Kosovën si viti që lamë pas. Ata kanë bërë me dije se spektri politik duhet të reflektojë për disa çështje me rëndësi të madhe për vendin. Sipas tyre, partitë politike duhet të gjejnë një konsensus nacional, sidomos për procesin e dialogut me Serbinë. Analistët kanë deklaruar për gazetën “Epoka e re” se sfida kryesore me të cilën do të përballen institucionet e vendit pas zgjedhjeve do të jetë dialogu Kosovë - Serbi

munden elitat tona politike të paktën të punojnë për hartimin e një platforme të përbashkët racionale dhe analitike në të gjitha aspektet rreth planit të ri të krijimit të një zone ekonomike rajonale të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor, që pas Marrëveshjes së Uashingtonit të 4 shtatorit ka gjasa se do ta ketë mbështetjen edhe të administratës së re të Bidenit dhe të BE-së si një propozim më konkret, më i prekshëm për nga investimet dhe dobitë për çdo vend dhe për rajonin në tërësi. A munden si prova të atdhetarizmit Albin Kurti, Enver Hoxhaj, Avdullah Hoti dhe liderët e tjerë t’i lënë anash zënkat për pushtetin e paqenë që u zgjat vetëm disa muaj, që të ulen dhe merren vesh për gjërat që janë më rëndësi jetike për të gjithë

ne?”, ka thënë Maliqi, duke shtuar se një konsensus i tillë është i domosdoshëm. “Epilog vështirë i imagjinueshëm, por i domosdoshëm nëse kuptohet se po, ne duhet të jemi të dinjitetshëm dhe vetja jonë në bisedimet për fatin tonë, por edhe se i gjithë procesi nuk mund të na nxjerrë fitues apo me ndonjë të mirëseardhur duke u thirrur në ato krekosje dritëshkurtra, se jemi shtet sovran që mund t’ia dalim të vetëm, duke ua bërë ‘vetingun’ interesave të miqve të dëshmuar që i kemi”, është shprehur Maliqi. Kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, beson se pandemia politike do të vazhdojë edhe pas zgjedhjeve në vend. “Në Kosovë pandemia politike do të vazhdojë. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e rrëzoi qeverinë

Hoti. Edhe ashtu kjo qeveri do ta kishte vështirë ta mbijetonte zgjedhjen e presidentit. Zgjedhjet e reja janë një mundësi për një legjitimitet të ri politik. Të kemi shpresë edhe për një qeveri stabile e që së paku pandemisë politike do t’i jepte fund. Kështu do të krijoheshin rrethanat për një betejë më të strukturuar politike, për një opozitarizëm të ri dhe për një përballje me pandeminë në fazat e fundit me institucione më të konsoliduara”, ka vlerësuar Murati.

Ai ka bërë me dije se testi kryesor edhe për qeverinë e re do të jetë përballja me Serbinë. “Këtu nuk kam shumë shpresë se një qeveri e re do ta ndryshojë kursin dhe do të jetë e vendosur që një herë e përgjithmonë ta heqë Serbinë nga jeta jonë e

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 JANAR - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se në vitin që po hyjmë skenës politike në vend i duhet unitet politik për disa çështje. Ata kanë deklaruar se partitë politike

pas zgjedhjeve duhet të arrijnë një konsensus nacional, sidomos për dialogun me Serbinë. Analisti Shkëlzen Maliq ka thënë për gazetën “Epoka e re” se liderët politikë duhet të hartojnë platforma të përbashkëta politike për çështje të caktuara. “A



brendshme me një marrëveshje me të cilën Kosova përfundimisht do të funksionalizohet. Po futemi në vitin e ri me plot shpresë se nuk do të jetë si ky që kaluam, se kemi mësuar diçka nga ky për njeriun, sjelljen njerëzore, dashurinë e solidaritetin dhe se do ta zbatojmë në jetën tonë personale dhe, po ashtu, në politikë”, ka vlerësuar Murati.

Kurse analisti tjetër Behxhet Shala ka deklaruar se asnjë parti e vetme nuk mund ta arrijë marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. “Edhe nëse LV-ja i fiton 65 deputetë, nuk besoj se do ta marrë përgjegjësinë për një marrëveshje me Serbinë, pa pajtimin e subjekteve të tjera kosovare. Është kafshatë që nuk kapërdihet e lëre më të tretet, edhe nëse kapërdihet me forcë! Albini këtë e ka të qartë. Po e mbushi pushkën për derra të egër, nëse na del lepur, do ta kemi më lehtë”, është shprehur Shala.

Ndërsa i sapoaderuari në PDK, Faton Abdullahu, ka thënë se zgjedhjet e reja janë një mundësi e mirë për ta flakur tutje një mendësi të vjetër. “Qytetari i Kosovës duhet ta ketë mundësinë që të votojë për ata që do ta mbrojnë shtetin e Kosovës në përballje me Serbinë, për ata që kanë guxim e nuk u ikin as përgjegjësive, e sidomos jo dialogut, për të mbetur vetë të pastër e për ta lënë Kosovën në lloç. Kjo nuk mund të bëhet pa

pasur raporte të mira, në të vërtetë shumë të mira me administratën e re Biden. Zgjedhjet e ardhshme duhet ta nxjerrin këtë mendësi politike, këtë kulturë politike, për një fitore të re e cila në variantin më të keq të humbjes dhe dështimit na u paraqitë vitin që po e lëmë pas”, ka thënë ai për gazetën “Epoka e re”. Sipas tij, qytetari i Kosovës para kutive të votimit me votën e tij duhet ta mbrojë UÇK-në. “Nuk janë të paktë ata, dhe kurrë nuk kanë qenë më arrogantë e më të bashkuar e të cilët i sulmojnë vlerat e luftës, konkretisht UÇK-në. Këta faqezi po mendojnë se sot mund të jesh kundër UÇK-së, në të njëjtën kohë me administratën e re Biden. E pamundur, këto dy vlera nuk shkojnë kundër njëra-tjetrës. Do të binden shumë shpejt”, ka vlerësuar ai.

Kosova dhe Shqipëria duhet ta rritin bashkëpunimin strategjik

Ish-zëvendëskryeministrja e Kosovës, Edita Tahiri, ka deklaruar për gazetën se Kosova dhe Shqipëria duhet t’u përgjigjen sfidave të reja globale dhe ta forcojnë bashkëpunimin. “Në kontekstin kombëtar shqiptar duhet rritur bashkëpunimin strategjik për t’i përballuar së bashku tensionet gjeostrategjike botërore. Ndonëse tash jemi dy shtete,

tokën shqiptare e kemi të përbashkët ashtu si edhe kombin shqiptar. Kosova dhe Shqipëria kanë obligime kombëtare për ta bashkërenditur politikën e jashtme në favor të gjeopolitikës perëndimore. Dëshiroj t’i lë në të kaluarën disa gabime historike që ndodhën pak vite më parë, ku disa liderë këndej dhe andej kufirit humbën busullën gjeopolitike duke bërë angazhime të gabueshme për ide të rrezikshme për prekje kufijsh. Besoj e kanë marrë mësimin dhe janë këndellur”, ka vlerësuar ajo.

Tahiri ka bërë me dije se në këtë vit Kosova duhet ta rimarrë veten në planin strategjik. “Në kontekstin e Kosovës, pavarësisht prej sfidave që kaluam këtë vit, me pandeminë shëndetësore e politike, të rënies së dy qeverive, dhe me Gjykatën Speciale, duhet ta rimarrim veten në planin strategjik dhe gjeopolitik. Jo vetëm që duhet t’i mbrojmë vlerat e luftës për liri dhe pavarësi, por duhet të jemi të zotët ta zhvillojmë vendin në planin ekonomik dhe ligjor, sepse ndikimet në sferën gjeopolitike varen nga fuqia e shtetit. Bota udhëhiqet me teorinë e realizmit në marrëdhënie ndërkombëtare, prandaj fuqia e shtetit përcakton ndikimin tonë në këto rrjedha. Duhet të kemi parasysh se kah po shkon bota, për të ditur kah do të shkojmë ne”, ka thënë Tahiri.

Tahiri: Ambasadori Braathu do të mbahet mend si një diplomat i drejtpërdrejtë

PRISHTINË, 4 JANAR (ER) - Zëvendëskryeministri Besnik Tahiri ka pritur të hënën në takim lamtumirës ambasadorin e OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu. Tahiri ka thënë se Kosova dhe populli i saj janë të bekuar që kanë miq ndërkombëtarë të cilët kanë kontribuar dhe shërbyer pa kursyer asgjë për ndërtimin e institucioneve dhe zhvillimin e vendit tonë. “Duke i uruar suksese në misionin e tij të ri, e falënderova përzemësisht ambasadorin Jan Braathu për shërbimin e tij dhënë në Kosovë dhe ritheksova se ai do të mbetet një ndër miqtë dhe diplomatët që ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për ndërtimin e institucioneve demokratike në Kosovë, mbi të gjitha për forcimin e partneritetit në mes të institucioneve të Kosovës dhe partnerëve

ndërkombëtarë, si dhe për shtyrjen e dialogut me komunitetet”, ka thënë Tahiri. Ai ka theksuar se përreth një dekadë në angazhimin e tij sa ishte ambasador i Mbretërisë së Norvegjisë dhe në veçanti, në kohën kur ka shërbyer shef i Misionit të OSBE-së, Braathu ka ndihmuar institucionet që lidhen me sundim të ligjit, qeverinë, shoqërinë civile, mediat dhe, po sipas Tahirit, ai ka ndihmuar edhe për forcimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe shtyrjen përpara të dialogut në mes të komuniteteve. “Ambasadori Braathu do të mbahet mend si një diplomat i drejtpërdrejtë, i sinqertë, i cili ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me institucionet, edhe kur është dashur të na japë sugjerime, por edhe kritika në funksion të forcimit të demokracisë dhe shtetit të Kosovës”, ka deklaruar Tahiri.



Lladrovci sfidon partitë e tjera: Kundër 30 kandidatëve fitoj veç vetë

DRENAS, 4 JANAR - Komuna e Drenasit gjatë vitit 2020 është shpallur komuna e parë për performancë në mesin e 38 komunave të Kosovës. Me këtë rast, kryetari i kësaj komune, Ramiz Lladrovci, ka thënë se ky vlerësim është rezultat i punës dhe bashkëpunimit që kanë pasur me qytetarët.

Lladrovci ka thënë se është i gatshëm të kandidoj edhe për një mandat nëse ia jep besimin Partia Demokratike e Kosovës (PDK), derisa është shprehur i bindur se do të vazhdojë të jetë në krye të Drenasit edhe për katër vjetet

e ardhshëm. “E pres vlerësimin e punës time nga Partia Demokratike e Kosovës dhe iu nënshtrohem plotësisht vendimeve të partisë. Në qoftë se partia e konsideron se unë duhet të vazhdoj edhe një mandat, atëherë do të kandidoj edhe për një mandat dhe do të jetë mandati i fundit si kryetar i komunës, sepse nuk do të kandidoj më shumë”, ka thënë Lladrovci për “Kosovapress”.

Ai është shprehur i bindur se do ta ketë besimin e qytetarëve për ta udhëhequr edhe për katër vjet Komunën

e Drenasit. Madje Lladrovci ka thënë se partitë e tjera po të nxjerrin 30 kandidatë, ai sërish do të fitojë. “Qytetarët e Drenasit, aq sa unë kam informacione, janë shumë të kënaqur me punën tonë. Nëse më pyet mua a je ti i kënaqur me punën tënde, unë kisha për të thënë që nuk jam, sepse kemi mundur dhe mund të bëjmë shumë më shumë. As nuk e diskutoj, jam shumë i bindur që qytetarët më besojnë edhe për një mandat. Nëse partitë e tjera i nxjerrin edhe 30 kandidatë, unë jam i bindur që kundër të 30-ve fitoj veç vetë”, ka thënë Lladrovci.



Dhjetë personalitete në Gjakovë nderohen me titullin ‘Nderi i Gjakovës’



GJAKOVË, 4 JANAR (ER)-Komuna e Gjakovës ka nderuar me titullin “Nderi i Gjakovës” dhjetë personalitete të shquara, ish-deputetë të Kuvendit të Kosovës, legjislaturë e cila më 2 korrik 1990 shpalli Deklaratën Kushtetuese dhe më 7 shtator të po atij viti shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e

njohur si “Kushtetuta e Kaçanikut”. Personalitetet e nderuara me këtë titull janë: Enver Pula, Fehmi Nallbani, Ruzhdi Bakalli, Gëzim Lipoveci, Leonora Binishi - Zajmi, Qemajl Sahatqija, Flamur Xhiha, Qefsere Boshnjaku - postmortem Mehmet Sahatqija - Post Mortum dhe Gani Vula - postmortem. Ndarjen e

këtyre dekoratave e kanë bërë nënkryetari i komunës së Gjakovës, Flamur Fetahaj dhe shefi i kabinetit të kryetarit Ardian Gjini, Agim Koci, të cilët në fjalën e tyre e kanë vlerësuar lart angazhimin dhe kontributin e ish-deputetëve të Kosovës në ato ditë të vështira për vendin tonë.

Shoqata e Pensionistëve, e të Burgosurve Politikë dhe ajo Invalidëve të Punës, bëhen me objekt të përhershëm

SHTIME, 4 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, me rekomandimin e Drejtorisë për Shëndetësi, ka marrë vendim që Shoqata e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, Kryqi i Kuq i Kosovës në Shtime dhe Shoqata e të Burgosurve Politikë në Shtime të vendosen në objekt të përhershëm, në të cilin do t'i

zhvillojnë aktivitetet e tyre ditore, ndërsa zyrat janë ndarë edhe për Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së. Nënkryetari i komunës, Rrahman Jakupi dhe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Musa Baftiu, kanë ndarë vendimet si dhe kanë vizituar objektin ku do të vendosen këto shoqata.



Pandemia vështirësoi gjendjen socio-ekonomike në Kaçanik

KAÇANIK, 4 JANAR (ER)- Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Kaçanikut ka njoftuar se ka përmbyllur vitin 2020 me shumë sfida që solli pandemia Covid-19. Drejtoresha e Shëndetësisë, Diana Reka Reka, ka falënderuar stafin mjekësor në QKMF në Kaçanik, i cili, sipas saj, ka bërë një punë të jashtëzakonshme, ndonëse i rrezikuar çdoherë

dhe në përballje me pandeminë. Ajo ka falënderuar të gjithë donatorët të cilët ndihmuan në forma të ndryshme gjatë kësaj kohe. Gjatë periudhës së pandemisë në Kaçanik janë ndihmuar 2 365 familje me pako ushqimore si dhe janë shpërndarë 62 875 kg miell dhe 390 pako higjienike. Situata në Komunën e Kaçanikut gjatë periudhës së

pandemisë ka vështirësuar edhe gjendjen socio-ekonomike. “Komuna e Kaçanikut, përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Shtabit Emergjent Komunal për Parandalimin e Covid-19, gjatë tërë kësaj kohe është munduar që të jetë afër familjeve në nevojë përmes ndarjes së pakove ushqimore”, ka njoftuar Komuna e Kaçanikut.



Bien rastet e të infektuarve me Covid në Kosovë



qytetarët që të vijnë të testohen për Covid sipas indikacioneve epidemiologjike, në të gjitha qendrat rajonale të shëndetësisë publike në Kosovë.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se laborja e infeksionit është në rënie. Ai ka bërë thirrje që të vazhdohet edhe më tej me respektim të masave dhe mbikëqyrje nga institucionet relevante.

Zemaj më herët ka deklaruar se institucionet e vendit janë të angazhuar që edhe Kosova ta ketë sa më parë vaksinën kundër Covid-19. "Si autoritete përgjegjëse në Kosovë jemi të angazhuar në mënyrë aktive të sigurojmë sasi të mjaftueshme të vaksinës. Për këtë çështje kemi formuar edhe komisionin për negocimin e furnizimit me vaksina kundër Covid si dhe kemi formuar edhe grupin punues për definimin e nevojave për vaksinën Covid-19. Covax Amc i Gavi-t do të sigurojë 20 për qind të vaksinave Covid-19 për 92 vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme duke përfshirë edhe ekonominë e tjera të kualifikuara nga Gavi dhe po bëjmë çmos që vaksinën Covid-19 ta kemi në dispozicion në tremujorin e parë të vitit 2021", ka thënë ministri Zemaj.

Deri më 8 janar në zonën e kuqe janë vetëm gjashtë komuna: Prishtina, Fushë-Kosova, Mitrovicë e Veriut, Zveçani, Zubin Potok dhe Leposaviqi.

Në zonën e verdhë, janë, po ashtu, gjashtë komuna: Mitrovicë e Jugut, Graçanica, Obiliqi, Podujeva, Juniku dhe Gjilani. Ndërsa, në zonën e gjelbër, janë 26 komuna:

Kllokoti, Lipjani, Gjakova, Kamënica, Ferizaj, Vushtrria, Peja, Drenasi, Skenderaj, Istogu, Deçani, Shtërpca, Klina, Shtimja, Novobërda, Vitia, Prizreni, Suhareka, Kaçaniku, Rahoveci, Malisheva, Hani i Elezit, Dragashi, Mamusha, Parteshi dhe Ranillugu.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë konfirmuar edhe 169 raste të reja me Covid-19. Ky virus u ka shkaktuar vdekjen edhe shtatë personave në Kosovë. IKShPK-ja ka njoftuar se viktimat janë nga Mitrovica, Peja, Istogu, Prishtina dhe Prizreni. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar nga Covidi edhe 313 pacientë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 JANAR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 050 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe

Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 169 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar shtatë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Mitrovicë dy raste (19, 77 vjeç), Pejë dy raste (75, 76 vjeç), Istog një rast (70 vjeç), Prishtinë një rast (80 vjeç) dhe

Prizren një rast (31 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 52 134 raste nga 188 138 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 351 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 313 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 42 948 raste, kurse numri i rasteve aktive është 7 835.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 81 raste,

Vushtrri 10 raste, Fushë-Kosovë 9 raste, Gjilan 7 raste, Lipjan 7 raste, Obiliqi 6 raste, Prizren 5 raste, Gjakovë 4 raste, Mitrovicë 4 raste, Podujevë 4 raste, Viti 4 raste, Ferizaj 3 raste, Klinë 3 raste, Pejë 3 raste, Rahovec 3 raste, Suharekë 3 raste, Deçan 2 raste, Istog 2 raste, Kamënicë 2 raste, Partesh 2 raste, Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Junik, Malishevë dhe Novobërdë. IKShPK-ja ka apeluar te të gjithë


Masat anti-Covid, për tri ditë policia shqiptoi 908 gjoba

PRISHTINË, 4 JANAR (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë, përveç përgjegjësisë për garantimin e rendit dhe sigurisë publike, ka ushtruar edhe autorizimet për ngritjen e nivelit të respektimit të masave anti-Covid.

Policia e rajonit të Prishtinës po punon që bashkërisht me të gjitha subjektet dhe të gjithë qytetarët ta parandalojnë përhapjen e virusit qoftë nga pakujdesia apo nga neglizhenca.

Vetëm në tri ditët e para të këtij

muaji për personat që nuk po respektojnë masat parandaluese janë shqiptuar mbi 908 gjoba dhe janë dhënë disa vërejtje e këshillime për respektimin e tyre. "E kuptojmë se është e domosdoshme lidhja njerëzore me njëri-tjetrin, por tani për tani duhet t'i respektojmë rekomandimet e kufizimet e vendosura pasi që ruajtja e shëndetit publik është një nga prioritetet e të gjithë neve", ka njoftuar Policia e Kosovës.





Viti i rikuperimit të dëmeve të pandemisë

PRISHTINË, 4 JANAR- Rimëkëmbja ekonomike dhe krijimi i vendeve të reja të punës duhet të jenë ndër prioritetet kryesore të Qeverisë së re të Kosovës për vitin 2021, thotë Arian Zeka, kryeshef ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane të Kosovës dhe Safet Gërxhaliu, ekspert për çështje ekonomike.

Gjatë vitit të kaluar, pandemia e shkaktuar nga koronavirusi dhe masat kufizuese për parandalim e saj, në Kosovë kanë ndikuar në përkeqësimin financiar të bizneseve dhe këto pasojë, sipas tyre, duhet të evitohen. Masat e deritashme të rimëkëmbjes ekonomike për ndihmë bizneseve të goditura nga pandemia, nga qeveria janë realizuar në mënyrë ad-hoc, thotë Arian Zeka nga Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës (OEAK).

Prandaj, gjatë këtij viti, qeveria e re, së bashku me partitë politike, përfaqësues të komunitetit të biznesit, ekspertë dhe profesorë universitarë duhet të hartojnë një strategji nacionale të zhvillimit ekonomik, thotë Zeka. "Pastaj, kjo strategji të mund të shndërrohet në një dokument që do ishte shtyllë e zhvillimit ekonomik në të ardhmen, edhe në rast të ndryshimit të qeverive, meqenëse tashmë po e shohim se realisht asnjë qeveri, jo

vetëm që nuk po mund të arrijë të përfundojë mandatin, por as gjysmën e tij", ka theksuar Zeka.

Edhe Safet Gërxhaliu, ekspert për çështje ekonomike, shprehet se institucionet e dala nga zgjedhjet e reja në fokus duhet të kenë rikuperimin për bizneset, sundimin e rendit dhe ligjit dhe përmirësimin e ambientit për investimet e huaja, sidomos për t'i motivuar investimet nga shtetasit e Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të botës. "Në këtë drejtim viti 2021 do të jetë mjaft sfidues. Nëse vendeve të rajonit do t'u duhen dy ose tri vjet për të marrë hapin për rimëkëmbje ekonomike, Kosovës do t'i duhet dyfishi sepse vërtet është bërë shumë pak për të mbështetur dhe sanuar pasojat e kësaj pandemie", ka deklaruar Gërxhaliu.

Duke marrë parasysh situatën e rëndë politike, pasi Kosova përmbylli vitin me qeveri në detyrë, Zeka dhe Gërxhaliu thonë se qeveria e re, që do të dalë pas mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme, me gjithë kapacitetin e vet duhet të angazhohet për rikuperimin e dëmeve ekonomike nga pandemia, pasi viti 2021 do jetë sfidues për shkak të pasojave të shkaktuara nga pandemia më 2020.

Qeveria e udhëhequr nga

GAP-i: Qeveria t'i ndihmojë bizneset në mënyrë proporcionale me dëmin

Sipas Administratës Tatimore të Kosovës, në nëntëmujorin e parë të vitit 2020 u deklaruan mbi një miliard euro më pak të hyra se në periudhën e njëjtë të vitit 2019. Nga kjo shifër, pandemia Covid-19 ka goditur në mënyrë joproporcionale industri të ndryshme të ekonomisë në Kosovë. Sipas një raporti të publikuar nga Instituti GAP, thuhet se aktivitetet ekonomike që kanë pësuar më se shumti humbje janë industria e arteve, argëtimit

dhe rekreacionit (79 për qind), patundshmëria (44 për qind), transporti, magazinimi (43 për qind), akomodimi dhe shërbimi ushqimor (37 për qind).

Ndihmat e qeverisë, sipas këtij instituti, deri më tani ka qenë uniforme për të gjitha industritë ekonomike, prandaj ky institut i rekomandon qeverisë t'i marrë parasysh industritë që kanë rënie më të lartë dhe t'i targetojë ato me fonde të cilat janë proporcionale me dëmin që kanë pësuar. Për t'u

rikuperuar ekonomia nga efektet negative nga Covid-19, Kuvendi i Kosovës pas shtatë dështimesh, më 4 dhjetor 2020 arriti ta votojë Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19. Në bazë të tij, ndërmarrjeve private u ofrohen lehtësira në aspektin financiar dhe ligjor. Në aspektin financiar qeveria në detyrë ka ndarë një fond prej 200 milionë eurosh për bizneset që kanë vështirësi financiare, shpërndarja e të cilave pritet të fillojë në muajt e parë të këtij viti.

Avdullah Hoti u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese pasi e shpalli të pavlefshëm votimin e Qeverisë së Kosovës dhe urdhëroi mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, duke e lënë qeverinë Hoti në detyrë. Për shkak të kësaj, Gërxhaliu vlerëson se ekonomia në këtë vit mund të dështojë pasi, sipas tij, edhe gjatë këtij viti do të dominojnë çështjet politike për shkak të zgjedhjeve që pritet të mbahen. "Mjerisht, në një vend ku agjenda politike

është e tillë, ngufatet ekonomia dhe mirëqenia sociale dhe shumë vende të rajonit nuk do të kishin pasur mundësi të përballojnë që të kenë tri qeveri brenda një viti kalendarik. Por, Kosova po sfidohej jo nga jashtë, por më shumë nga brenda nga mosstabiliteti politik", ka theksuar ai.

Ndërkaq Arian Zeka shprehet se ndikimi ekonomik që pandemia ka pasur në ekonomi, pashmangshëm do të bartet edhe gjatë këtij viti.

Por, ai thotë se kërkohet reagimi i institucioneve kompetente. "Për të mos tingëlluar shumë pesimist, nëse bazohemi se çfarë ka ndodhur në vitin 2020 dhe si ka qenë reagimi institucional, atëherë shpresat janë të shohim një rikuperim të shpejtë dhe të plotë brenda vitit 2021. Në fakt, ajo që duhet cekur është se ka mundësi që efektet e krizës të vërehen edhe në vitin 2022 e tutje", thekson Zeka.

Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19 synon t'i fuqizojë bizneset dhe t'i mbështesë qytetarët

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 JANAR- Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, ka bërë me dije se planprogrami i Qeverisë së Kosovës 2020-2023 parasheh një sërë reformash të rëndësishme të cilat synojnë fuqizimin e ekonomisë së Kosovës në periudhën pas pandemisë. Ajo ka thënë se këto reforma kërkojnë një periudhë të caktuar kohore për t'u përbushur në tërësi. Duke folur për mjetet e planifikuar për rimëkëmbjen ekonomike për vitin 2021, ministria Bajrami ka thënë se në Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19, i cili është aprovuar tashmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë përcaktuar masa të rëndësishme të cilat synojnë t'i fuqizojnë bizneset dhe t'i mbështesin qytetarët e Kosovës. "Një nga to është ulja e TVSh-së për hotelerinë dhe gastronominë nga 18 për qind në 8 për qind; rritja e kapitalit

të Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive, përmes të cilit do të përmirësohet ndjeshëm qasja në financa e kompanive të Kosovës, e fermerëve, por edhe e grave në biznes. Po ashtu, një nga masat e mbështetjes direkte financiare për bizneset përfshin shumën prej 200 milionë eurosh përmes së cilës do të ndahen mjete për bizneset e goditura nga pandemia. Masa tjetër shkon në mbështetje të punëtorëve të cilët e kanë humbur vendin e punës për një periudhë tremujore gjatë kohës së pandemisë, për të cilët do të paguhet një shumë prej 300 eurosh për tre muajt", ka deklaruar Bajrami.

Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, ka treguar se kanë zbatuar pjesën më të madhe të masave të Pakos së Rimëkëmbjes për vitin që lamë pas, me përfutjes mbi 36 mijë biznese. "Kemi financuar shëndetësinë, arsimin, kulturën, sportin, policinë si dhe u kemi dalë në mbështetje



familjeve në asistencë sociale të cilave ua kemi dyfishuar të hyrat për tre muajt e fundit. Në aspektin e harmonizimit të legjislacionit në fushën e financave publike në harmoni

me obligimet e dala në Marrëveshja për Stabilizim Asocim, gjatë kësaj periudhe kemi aprovuar në qeveri 16 ligje të rëndësishme. Kemi lansuar procesin e përgatitjes

së Programit të Reformave në Ekonomi 2021-2023 dhe tashmë drafti i përgatitur është publikuar në platformën për konsultime publike", ka theksuar ministria Bajrami.

Rritet bashkëpunimi në turizëm në mes të agjencive të Shqipërisë dhe të Kosovës

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 JANAR- Ministri i Turizmit dhe i Mjedisit në Shqipëri, Blendi Klosi, ka bërë me dije se është rritur bashkëpunimi në turizëm në mes të agjencive të Shqipërisë dhe të Kosovës. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se duhet të vazhdohet ky bashkëpunim

edhe në të ardhmen. "Është rritur dhe forcuar bashkëpunimi mes agjencive shqiptare në të dyja anët e bjeshkëve. Në çdo shkëmbim zyrtar vizitash kemi ndihmuar lehtësimin e këtij komunikimi dhe bashkëpunimi mes sektorit privat, me një qëllim: Turizmi në të dyja anët e bjeshkëve duhet të jetë komplementar për ofrimin e

produkteve turistike. Kemi bashkërenduar tashmë agjendat, prej më shumë se dy vjetësh: Hapim sezonin turistik veror në Shqipëri në fillim të qershorit në Shëngjin me homologët nga Prishtina, me tur operatorët dhe agjencitë turistike të dy vendeve tona dhe, gjithashtu, bashkë hapim sezonin turistik dimëror në Dragash të Kosovës në fillim -

vjeshte. Është jo vetëm një ushtrim praktik, por një mesazh i rëndësishëm me moton "Pusho shqip" në të dyja anët e bjeshkëve. Duhet të kemi parasysh se jemi tregje turistike të vogla, por duhet ta shfrytëzojmë diversitetin e natyrës dhe burimeve natyrore për t'i shndërruar në avantazh ekonomik. Ndaj në këtë drejtim ka shumë për të

bërë e se në turizëm shumë nuk është kurrë mjaftueshëm pasi është një sektor dinamik. Ajo që nuk duhet të ndalim është fryma e bashkëpunimit dhe konsolidimi i marrëdhënieve në të gjitha nivelet: sektor publik e privat", ka deklaruar Klosi.

Duke folur për hartimin e ndonjë strategjie e cila do të kontribuonte në rritje të bashkëpunimit në mes të dy shteteve, Klosi ka theksuar se për këtë gjë kanë diskutuar me përfaqësues të institucioneve të Kosovës. "Me kolegët e Prishtinës e kemi diskutuar shpesh si të bëjmë më të mirën në këtë drejtim. Kemi ngritur tashmë një platformë të zhdërvjellët komunikimi, me të gjithë, ministritë e linjës, pushtetin vendor, sektorin privat, se si duhet të operojmë në forma afatgjata për ta çuar përpara zhvillimin e kësaj industrie. Dhe mendoj se kjo është rruga. Asnjë injektim financiar nuk zëvendëson punën konkrete dhe të drejtpërdrejtë për ta orientuar tregun dhe për ta nxitur sektorin privat drejt kësaj rruge. Në fund është sektori privat që duhet të punojë dhe ta nxisë drejt konsolidimit të bashkëpunimit", ka pohuar ministri Klosi.



Disa pika të një programi eventual politik ndaj Serbisë



Milazim KRASNIQI

Programet politike e qeverisë në Kosovë duhet të jenë brenda kësaj kornize: 1. Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë, prandaj duhet të gjenden rrugët ligjore që të paditet në Gjykatën e Drejtësisë për gjenocid. 2.

Plani i Ahtisarit ka qenë kompromis i madh që ka bërë Kosova për komunitetin serb dhe për statusin e Kishës Ortodokse Serbe. Ai kompromis është bërë duke u udhëhequr nga ideja që Plani do të pranohet nga Serbia dhe Kosova do të anëtarësohet në OKB. Meqë Serbia e ka refuzuar atë Plan, ai duhet të rishikohet, me mundësi suspendimi në këto dy pika, derisa Serbia ta pranojë Planin e Ahtisarit. 3. Dialogu në Bruksel, i ndërmjetësuar nga BE-ja, duhet të vazhdojë, por i

afatizuar dhe në fillim duhet të arrihet marrëveshja për njohje e mandej të zërthehen modalitetet. 4. Pozita e shqiptarëve në Luginën e Preshevës duhet të përfshihet në dialogun e Brukselit, minimalisht në kuadër të zbatimit obligativ dhe në pako nga ana e Serbisë të Kartës Evropiane për Qeverisje Lokale. 5. Serbia duhet të japë informatat e plota lidhur me të zhdukurit. 6. Serbia duhet të kthejë fondet pensionale dhe të gjitha vlerat arkeologjike dhe kulturore që janë plaçkitur nga

autoritetet serbe gjatë luftës në Kosovë. 7. Partitë serbe të regjistruara në KQZ në Kosovë, nëse nuk respektojnë kuadrin kushtetues dhe ligjor të vendit, do të fshihen nga regjistri i partive politike. 8. Sistemi i arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe planifikimit hapësinor duhet të funksionojnë brenda sistemit unik të Kosovës, ndërsa disa nga kompetencat do t'u barten komunave dhe bashkësisë së komunave më shumicë serbe. 9. Ndaj politikanëve, ushtarakëve dhe policëve të

Serbisë që kanë marrë vendime dhe kanë zbatuar vendimet gjenocidale në vitet 1998-1999, do të ngrihen padi në gjykatat e Kosovës. 10. Fqinjësia e mirë mbetet objektiv strategjik i Kosovës edhe në raport me Serbinë. Por, për çdo deklaratë dhe vendim kundër interesave të Kosovës, që japin/ndërmarrin autoritetet serbe, do të bëhen denoncime në KS të OKB-së dhe në institucionet e tjera ndërkombëtare. Fqinjësia e mirë do të mbështetet në reciprocitet.

Në oborrin e shtëpisë së Rifat Berishës (1910-1949) në Berishë

Nga: Ismail SYLA

Rifat Berisha ishte një ndër personalitetet e rralla kombëtare që iu mbet besnik vendimeve të Konferencës së Bujanit (1943/1944). Ai, ndonëse kryetar i Frontit Popullor të Kosovës, ra ndesh me politikën jugosllave e cila nuk e zbatoi premtimin e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, kur të përfundonte Lufta e Dytë Botërore. Rifat Berisha i shpëtoi arrestimit të OZN-ës serbe dhe në luftë me forcat policore dhe ushtarake serbe, vritet në fshatin Gajak, duke tentuar të arratiset në Shqipëri. Sot gjurmët e fundit të shtëpisë, bunarit dhe disa drurëve të vjetër mezi rrinë në këmbë. Është e pafalshme që dhëmbi i kohës të kafshojë çdo gjë. Moskujdesi institucional dhe

familjar për këtë trashëgimi është për çdo qortim.

Aty ende janë vijat në lëndinë të dhomës së Rifatit, i cili u martua me Mirije Çanon nga Gjirokastra, në kohën kur mori mësimet ushtarake në Tiranën e kohës së mbretit Zog.

Ende është bunari, afër të cilit gjendet një kajsë shekullore.

Pak kohë para se të bie ndesh me forcat e sigurimit policor dhe ushtarak serb, Rifati kishte filluar ndërtimin e shtëpisë. Nuk arriti ta përfundonte tërësisht, por vetëm sa u rrafshuan muret deri te hatulla e dytë. Gurët kanë mbetur në fund të rrënojës. Vetëm një kënd i shtëpisë ka mbetur i dallueshëm edhe sot. Në oborrin e Latif Berishës ende rri në këmbë mani me emrin "Dudi i hallës Hyrë" (i gjyshes së Halit Berishës).

Në një parcelë tash të lëvruar ende vërehet dhe mbi të cilin ishte ngritur kulla e Tahir

Berishës. Poshtë saj, mezi rri në këmbë arra shekullore e Tahir Berishës.

Pak më poshtë arrës janë dy lisa të mëdhenj dhe të vjetër. I pari ka një zgavër sa mund të strehohen tre njerëz. Aty, pas vrasjes së Rifatit, Halitit i linin ushqim familjarët, sepse ai lëvizte nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas.

Edhe një lis tjetër i po asaj madhësie është disa metra ma poshtë.

Dy lisat dhe arra shekullore janë monumentet e fundit të trashëgimisë së Berishëve (Tahirit, Rifatit, Halitit) thotë një trashëgimtar i sotëm i Berishëve, Eshrefi, 56 vjeçar, drejtor i shkollës fillore "Rifat Berisha" në Berishë, që sot i takon administrativisht komunës së Malishevës.

Një film dokumentar do të duhej bërë sa më parë për t'i regjistruar shenjat e fundit të një trualli lavdimadh.



MONUMENTI LETRAR I SKËNDERBEUT

Trilogjia “Gjergjat në drita përkrenarësh”, Avni Dehari, sh. b. “Orfeu”, Prishtinë, 2018

Prof. Shaip EMËRLLAHU

Ka shumë monumente që i janë kushtuar figurës legjendare të Skënderbeut. Është, para së gjithash, ai monument që atij ia ka skalitur plot venerim populli ynë në epose e në këngë epike. Janë monumentet në skulpturë, në pikturë dhe në vepra simfonike. Po ashtu, janë veprat e shumta memorialistike, historike e letrare që nisin qysh nga vepra e parë e Marin Barletit “Historia e Skënderbeut”, pastaj me botime të Dhimitër Frankut, Gjon Muzakut, për të vazhduar më pas me poemat e Jeronim de Radës (Skanderbeku i pafan), Naim Frashërit (Histori e Skënderbeut), të ndjekura me vepra të Fan Nolit, Ismail Kadaresë, Sabri Godos, Bilal Xhaferit..., si dhe shumë krijime të tjera në prozë e poezi. Për këtë simbol të qëndrësës shqiptare, në mbrojtje të trojeve të veta, por që u bë një kështjellë mbrojtëse edhe për vetë Evropën e kohës, janë të panumërta nga një varg autorësh evropianë e botërorë: studime historike, romane kalorësiake, poema, piktura, opera, simfoni..., të cilat e vlerësojnë lart këtë figurë, duke e renditur atë pa mëdyshje, mes rrethit të ngushtë të personaliteteve më të shquara të të gjitha kohërave.

Ndër aktivitetet e shumta mbarëkombëtare, që po organizohen gjatë vitit 2018, i shpallur ky si Viti i Skënderbeut, në përkujtim të 550 vjetorit të vdekjes së tij, merr një vlerë të posaçme edhe prezantimi/promovimi i sotëm i trilogjisë “Gjergjat në dritë përkrenarësh”, e botuar në Prishtinë nga shtëpia botuese “Orfeu”, me autor Avni Dehari. Duhet të sjellim në vëmendje se, autori është tashmë i njohur për lexuesin me një krijimtari të kahershme, e botuar kjo krijimtari në Kosovë, në Shqipëri dhe në Zvicër. Përgjithësisht, ato vepra i janë drejtuar lexuesve të moshave shkollorë, duke tentuar të përcjellin mesazhe edukative patriotike e morale, të gërshetuara këto mesazhe edhe me informacion historik, etnografik e gjeografik për vendlindjen, për dheun e të parëve. Këto krijime, metaforikisht mund t’i përfaqësojmë si stacione të larmishme e të këndshme, ku lexuesit, adoleshentë e të rinj, janë endur me flatrat e fantazisë së tyre nëpër kohë dhe nëpër vise të ndryshme të atdheut të tyre. Atje kanë takuar heronj të historisë, rapsodë e mentorë të

urtë, prej të cilëve, fitojnë dhe formojnë personalitetet dhe identitetet.

Por, kjo vepër e re, e konceptuar si trilogji, përbën një arritje të shënuar jo vetëm për autorin, por edhe për pasurimin e fondit, tashmë aq të vyer të botimeve skënderbejane. Dhe ky është një fond që mbetet përherë i hapur, pasi figura e heroit tonë, Gjergj Kastriotit, është një pikë e fortë referenciale për t’iu drejtuar kësaj figure në çdo kohë e në çdo situatë që kalon kombi ynë. Madje, ai është po aq pikë referenciale edhe për të tjerët, për ata përtej nesh, sidomos si simbol i vlerave dhe i fuqisë që vijnë prej bashkimit. Ky bashkim është ajo energjia vigane, që e bën të fortë edhe të voglin, i cili mund të triumfojë si Davidi i lashtësisë me Goliatin. Po ashtu, ky bashkim gjeneron vlera të mëdha - si simbol i bekimit të sakrificave, kur ato bëhen imediatisht për vendin tënd. Por, po aq janë të bekuara, kur ato sakrificat bëhen edhe për mbrojtjen e vlerave progresiste evropianiste. Heroi ynë, Gjergj Kastriot Skënderbeu, ishte pikërisht një misionar i tillë, prijatar i popullit të vet, por edhe një vizionar dhe kalorës i lirisë, që vështronte përtej oborrit të shtëpisë e të fisit të vet. E kjo i ka dhënë atij vlerësimet aq të larta prej kancelarive dhe prej figurave botërore, nëpër rrjedha të të gjitha kohëve. Mjaft nga studiuesit evropianë, kanë shkruar me dokumente e argumentuese në ato kohë të vështira, shqiptarët i dhanë më shumë Evropës se ç’përfituan prej saj, duke e transkriptuar sot këtë konstatim, edhe si një borxh të madh të saj, ndaj këtij vendi të vogël. Një borxh ky, që matet me shumë e shumë jetë njerëzish të vvarë, me shumë pasuri e shumë vise të shkatërruara e të braktisura, në përballje me fuqinë më të madhe pushtuese të kohës - Perandorisë otomane.. Trilogjia e veprës, është e konceptuar në një unitet të brendshëm. Pra, rrjedh jeta e heroit në tre pamje themelore: fëmijëria në vendlindje, në mjediset familjare të Kastriotëve, pastaj marrja peng së bashku me të vëllezërit nga sulltani, ku ai rritet dhe kunis t’i zgjohet ndjenja e detyrës ndaj atdheut, deri sa do të vijë çasti që të marrë mbi vete barrën e udhëheqësit të popullit në rrugën e lirisë. Kjo është kurba e jetës së heroit, ku spikatën tërë ato vlera, që tani i takojnë historisë së tij të lavdishme. Kjo histori i ka hedhur atij mbi krye kurorën e lavdisë, që jo vetëm nuk zbehet



në rrjedhë të shekujve, por ajo merr shkëlqim përherë edhe më të madh.

Në të gjitha episodet e përshkuara, figura e Skënderbeut është vizatuar artistikisht, sa në dimensionin e tij heroik, aq dhe atë njerëzor. Kjo mënyrë trajtimi e bën të afërt me lexuesin, duke ndërtuar raporte komunikuese me të dhe kjo krijon premisat e nevojshme, që ky lexues i ri t’i bëjë të vetat natyrshëm vlerat e përcjella. Pra, të shikojë te Skënderbeu heroin, monumentin e historisë, por edhe njeriun e gjallë, të cilit i ndjen gjithçka posi një njeriu që e ka përballë: edhe emocionet, edhe mëdyshjet, gëzimin dhe hidhërimin e dramën njerëzore. Këtu mendojmë se ruhet një baraspeshë e vlerësuar, sepse vërtet kemi të bëjmë me një Skënderbe të letërsisë, pra, një figurë fiktion, por ama autoriteti dhe pesha e tij historike e kërkojnë edhe një kufizim nga letërsia e tepërt. Duket se, autori e ruan mirë këtë raport, duke i kombinuar të dyja kompetencat: ato letrare dhe ato historike. Sigurisht, që të arrihet kjo, nuk është aq e lehtë dhe nuk funksionon me receta. Ajo arrihet menjë kombinim mes intuitës dhe inteligjencës e finesës artistike.

Trilogjia çelët me tregimin që rrëfen lindjen e Dragoit të Arbërisë, Gjergj Kastriotit, si një shenjë e bekuar për shqiptarët. Gjijn Aleks, komandant Tanushi,

Kamani, Krutani, Mrika, Gjoni e gjithë bujarët e luftëtarët e kohës, në këtë çast solemn, përshkruhen të ndezur nga hareja e ia marrin një valleje të moçme lufte. Është një skenë vërtet prekëse: fyelltarëve sa s’u pëlcastin bulçitë prej ngazëllimit, lahutat, gajdet dhe kavallet jehojnë si kurrë më parë. “Rroftë Arbëria”, “Rroftë Gjergji”, oshtin Kruja, oshtijnë malet si kurrë më parë. Dhe tregimi që mbyll trilogjinë, përshkruan çastin kur në shtratin para vdekjes, Gjergji dëshmon porosinë e tij të madhe të bashkimit mes shqiptarëve, që tashmë është bërë legjendë. Është ai moment i paharruar, që vjen si porosia e heroit nëpër shekuj, kur ai u vendos përpara bashkëluftëtarëve të tij - tufën e thuprave. Të bashkuara, ato nuk thyhen dot prej një dore, por thyhen aq lehtëza të veçuara. Pra, përcillet porosia e bashkimit të aspiratave dhe të energjive mes shqiptarëve, porosi dhe mësim që mbeten aq aktual e të çmuar edhe sot e kësaj dite. Pikërisht brenda kornizës së këtyre dy tregimeve, si hyrje e si përmblylje e tërë veprës, ndërtohet gjithë jeta e begatë e Heroit tonë kombëtar. Figura e Gjergj Kastriotit, zbulohet me mjeshtëri në këta tre libra të autorit Avni Dehari, sa në rrafshin heroik, aq edhe në atë njerëzor. Ai shfaqet si udhëheqës e strateg vizionar, por edhe luftëtar i sypatrembur i betejave mes ushtarëve të tij. Kjo e dëshmon qartazi profilin e tij, si


një lider i lidhur fort ngushtë me popullin e vet, që vjen si apel dhe si model mjaft ndikues edhe për kohët e sotme.

Janë mjaft pjesë të këtyre librave që shpalosin në mënyrë bindëse e plot emocion skena të larmishme nga jeta e Skënderbeut: mes malësorëve, në kuvende me bashkëluftëtarët e në beteja me armiqtë, në marrëdhënie me kancelaritë e kohës dhe me përballimin e kurtheve, intrigave e lajkave prej oborrit sulltanor dhe prej atyre të vetëve, që i ishin shitur armiqve. Pikërisht tërë kjo atmosferë e ndërlikuar, nga njëra anë mes pengesash dhe nga ana tjetër mes atij besimi e vetëmohimi për të përballuar e sprapsur pushtuesit, i japin kësaj figure një profil të lartë madhështie e nderimi të pasosur në shekuj. Poeti ynë kombëtar, Naim Frashëri, në veprën e tij të gjatë epike Histori e Skënderbeut, mes të tjerash, e përshkruan bukur e me solemnitë emocional çastin e kthimit të Skënderbeut në Krujë, ku shquajnë vargjet:

Krujë, o qytet i bekuar,
Prite, prite Skënderbenë
Po vjen si pëllumb i shkruar,
Të shpëtojë mëmëdhenë...
Dhe heroit ynë, në këtë çast të madh historik, vinte të shpëtonte jo vetëm Shqipërinë, por edhe qytetërimin evropian. Sepse, sikundër ka shkruar shkrimtari ynë i përmasave botërore, Ismail Kadare, ai nismëtoi (projektoi) programin më evropianist shqiptar dhe se historia heroike e kthyer tashmë në mit e Skënderbeut, ka qenë dhe mbetet një histori fund e krye:shqiptare dhe evropiane. “Është pjella e parë e përbashkët e Shqipërisë me Evropën dhe, si e tillë, përveç që na nderon, na jep shpresë...”, shprehet në mënyrë thelbësore e lapidare shkrimtari Kadare.

Kjo trilogji e shkrimtarit Avni Dehari, i drejtohet gjithë lexuesit shqiptar, e sidomos shkollarëve e të rinjve, duke mbartur kështu një mision të lartë edukimi për ta. Për Gjergj Kastriotin, ka shumë monumente madhështore të derdhura në bronz: në sheshet e Tiranës, Krujës, Prishtinës, Shkupit, Romës, Zvicrës... Edhe kjo trilogji, është një monument, në këtë rast një monument i derdhur me fjalë zemre prej gjuhës sonë shqipe, asaj gjuhe, që buronte e gjëmonte në gojën e heroit tonë legjendar.

Kumtesë e lexuar me rastin e përvitit të trilogjisë “Gjergjat në drita përkrenarësh” të shkrimtarit Avni Dehari, Shkup, 2018.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Shkëmbi, pas prezantimit: Kemi synime të qarta me Ballkanin

Strategu shqiptar Bledi Shkëmbi ka thënë se i ka synimet e qarta me skuadrën e Ballkanit nga Suhareka. “Këtu objektivat janë të mëdha dhe është një klub me objektiva të qarta. Vijë me dëshirën dhe bindjen se këtu do të kem sukses. Klubi dhe skuadra kanë bërë një punë të shkëlqyer, përfshirë edhe ish-trajnerin Munishi që kam shumë respekt”, ka thënë ai. Ndërsa klubi njoftoi se Francesco Vitobello dhe Alban Shala do të jenë ndihmësit e Shkëmbit



për lojtarët që kanë atë çka duhet për titullin”, ka deklaruar trajneri shqiptar.

Skuadra e Ballkanit kishte paraqitje fantastike gjatë sezonit vjeshtor, por në disa ndeshje të fundit forma e kësaj skuadre pësoi rënie dhe e humbi pozitën e parë. Pas kësaj erdhi edhe shkarkimi i Ismet Munishit dhe emërimi i Bledi Shkëmbit në krye të shtabit teknik, në mënyrë që ky klub ta ndjekë titullin e kampionit në Superligë, në të njëjtën kohë synon triumfin edhe në garën e Kupës. Ballkani sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e dytë në tabelë me 38 pikë të grumbulluara, tri me pak se Drita që mban pozitën e parë dhe gjashtë më shumë se Prishtina që pozicionohet e treta në renditjen tabelore. Klubi që drejtohej nga Ismet Munishi në sezonin vjeshtor nga 18 ndeshje regjistroi 12 fitore, 2 barazime dhe 4 humbje.

shpalosur dinamika e ardhshme për sa i përket fazës përgatitore”, thuhet në njoftimin e Ballkanit. Shkëmbi e ka zëvendësuar në postin e trajnerit, Ismet Munishi, i cili vlerësohet më meritori për ngritjen e nivelit të Ballkanit në elitë gjashtë dy vjetëve të fundit. Trajneri nga Shqipëria është i bindur se në skuadrën e Ballkanit suksesi nuk do të mungojë, pasi është një klub me futbollistë cilësorë dhe është bërë një punë të

madhe. Shkëmbi ka lavdëruar edhe punën e Munishit se ishte trajner i kësaj skuadre. “Falënderoj drejtuesit e klubit për besimin. Është një kënaqësi dhe pas trajnimit të Lirisë e kam ditur se një ditë do të kthehesha në Kosovë. Këtu objektivat janë të mëdha dhe është një klub me objektiva të qarta. Vij me dëshirën dhe bindjen se këtu do të kem sukses. Klubi dhe skuadra kanë bërë një punë të

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

SUHAREKË, 4 JANAR - Trajneri nga Shqipëria, Bledi Shkëmbi, është prezantuar të hënë në skuadrën e Ballkanit. Klubi nga Suhareka ka njoftuar se ndihmës të Shkëmbit do të jenë Francesco Vitobello dhe trajneri kondicional Alban Shala. “Në takim është bërë njoftimi formal ndërmjet stafit të ri dhe futbollistëve si dhe është

shpalosur dinamika e ardhshme për sa i përket fazës përgatitore”, thuhet në njoftimin e Ballkanit. Shkëmbi e ka zëvendësuar në postin e trajnerit, Ismet Munishi, i cili vlerësohet më meritori për ngritjen e nivelit të Ballkanit në elitë gjashtë dy vjetëve të fundit. Trajneri nga Shqipëria është i bindur se në skuadrën e Ballkanit suksesi nuk do të mungojë, pasi është një klub me futbollistë cilësorë dhe është bërë një punë të

Binçe: Dëshiroj të luaj për Kosovën

PRISHTINË, 4 JANAR - Basketbollisti Norik Binçe, edhe pse është vetëm 15-vjeçar, ka depërtuar shumë shpejt dhe luan me sukses në Kroaci. “Jam pjesë e Cibonës në Kroaci, ku luaj për U17. Më herët kam qenë pjesë e skuadrës Joker, ku jam stërvitur me trajnerin Jadran Vujačić. Por, në fillim të janarit pres t'i bashkohem skuadrës KK Zadar. Deri më tani jam shumë i kënaqur, por sigurisht se pres shumë në të ardhmen”, ka thënë

Noriku për faqen zyrtare të FBK-së. Basketbollisti 195 cm ka katër vjet që ka filluar të luajë basketboll. “Në Mal të Zi jam rritur shumë, ku pastaj kam depërtuar në Cibonë dhe më pas në Zadar. Kam luajtur në M Junior, pastaj te Prishtina e Re, nga mosha 11-vjeçare”, është shprehur ai. Dëshira e tij është që një ditë të luajë për “dardanët”. “Kam pasaportë të Kosovës dhe të Kroacisë dhe

jam duke shikuar për të ardhmen. Në të ardhmen sigurisht se do të doja të luaja për Kosovën, por për momentin ende nuk kam vendosur. Jam i fokusuar në skuadrën kroate”, ka shtuar Binçe. “Të luaj në Eurocupe ose në Euroligë, e më pas në Champions League. Por, më pret një punë e madhe për ta realizuar ëndrrën. Jam vetëm 15-vjeçar dhe duhet shumë punë për suksese”, ka përfunduar Norik Binçe.



Muça: Prishtina ma heq mërzinë e Tiranës



TIRANË, 4 JANAR - Gentian Muça la këtë verë ekipin e zemrës, Tiranën, teksa u transferua në Kosovë, përkatësisht në skuadrën e Prishtinës. Në një intervistë për “Top Channel”, Muça tregon se e kanë pritur shumë mirë te Prishtina, duke i lehtësuar edhe mërzitjen e largimit nga Tirana. “Më shumë

se lëvizja për në Kosovë ishte ndërrimi i ambientit pas më se 10 vjetësh. Isha mësuar me këtë rutinë, por gjithsesi klubi, shokët e skuadrës të gjithë më kanë bërë të ndihem mirë. Koha e përshtatjes ka qenë shumë e shkurtër, pavarësisht se ndodhi në mes të sezonit. Në çdo kryeqytet të Evropës të kisha

shkuar do të ndihem mungesa, por në Prishtinë më kanë bërë të ndihem shumë mirë dhe ma kanë lehtësuar mërzitjen e largimit, sepse mërzitja ishte shumë e madhe, por u bë për arsye profesionale”, ka thënë Muça, i cili nuk e përjashton rikthimin në skuadrën e Tiranës.

Boksierët vazhdojnë përgatitjet në Durrës

PRISHTINË, 4 JANAR - Përfaqësuesja e Boksit e Kosovës (seniorë dhe të rinj - Youth 17-18-vjeçar) është duke i vazhduar përgatitjet në

Durrës. Federata e Boksit e Kosovës vazhdon sipas planprogramit të paraparë për përgatitje dhe pas Durrësit boksierët seniorë

përgatitjet do t'i vazhdojnë në Zagreb të Kroacisë deri në fillimin e kampionatit ballkanik që do të mbahet në fund të muajit janar në

Zagreb. Përgatitjet do të zhvillohen tri herë në ditë gjithnjë duke respektuar këshillat e dala nga MSh-ja, MKRS-ja dhe IKShP-ja.



Mick Schumacher: Ky është objektivi im dhe i skuadrës për sezonin e ri

WASHINGTON, 4 JANAR - Mick Schumacher do të debutojë këtë vit në Formula 1 me makinën amerikane Haas, e cila vjet nuk ka qenë shumë kompetitive në pistë. Njëvendëshja amerikane, që përdor motorin Ferrari, ka

pasur shumë problem, që pritet ta pasojë edhe këtë vit. Ndaj Mick, djali i Michael Schumacherit, nuk pret shumë nga debutimi i tij në Formula 1. "Nëse arrijmë të shkojmë në sesionin e dytë të provave zyrtare (Q2) do të ishte një

fitore e madhe për ne. Pra, të jemi brenda 15 makinave të para në startin e garës. Ky është objektivi im dhe i skuadrës për sezonin e ri", ka thënë Mick Schumacher. "Nuk dua të vendos si objektivi të pamundurën, të kërkoj gjëra të

vështira për t'u arritur. Objektivi më i madh është përmirësimi im si pilot dhe të ndihmoj në zhvillimin e makinës. Mendoj se jam gati për këtë sezon të parë në Formula 1, jam përgatitur ashtu si duhet", ka deklaruar Schumacher.



Nuhiu: Më mbetet merak eliminimi nga Evropa Liga

GJILAN, 4 JANAR - Trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu, përveç që shpalli Dritën kampione të Superligës së Kosovës për edicionin 2019/20, është në rrugë të mbarë për ta mbrojtur këtë titull ani pse është ende shumë herët. Nuhiu për këtë sukses ka marrë edhe çmimin e trajnerit të vitit 2020 në Kosovë. Gjilanasi kishin marrë pjesë në parakualifikimet e Ligës së Kampionëve, por që kishte hasur në raste me Covid-19 dhe ishin eliminuar. Kurse në Ligën e Evropës arritën ta mposhtin Sileksin e Maqedonisë së Veriut, për t'u eliminuar më pas nga Legia e Varshavës. Ardian Nuhiu i kishte mbetur merak eliminimi nga Liga e Evropës pasi, sipas tij, Drita kishte plane të mëdha. "Gjithmonë do të kërkojmë të rritemi dhe të vetëdijsohem. Ne arritëm të dalim kampion, por duhet të mos kënaqemi me kaq. Do të kërkoj edhe këtë vit



edhe në të ardhmen ku do të punoj, të kemi suksese. Pjesa që më ngelet merak është eliminimi nga Evropa, sepse kishim plane të mëdha. Por më vjen mirë që futbollistët shkruan histori duke kaluar Sileksin në Ligën e Evropës. Patëm përballë një kundërshtar të fortë, por

shohim përpara dhe synimet janë të rritemi dhe të ecim para nga viti në vit", ka thënë Nuhiu për "Koha.mk". Ndryshe, Drita ka mbyllur stinorin vjeshtor në elitën e futbollit të Kosovës në pozitën e parë me 41 pikë, tri më shumë se Ballkani që zë vendin e dytë.

Curry magjik, 62 pikë në suksesin e Golden States

SAN FRANCISCO, 4 JANAR - Pasi e nisën sezonin e ri me pesë humbje radhazi, Washington Wizards gjeti fitoren e dytë radhazi, këtë herë me vetëm një pikë diferencë 122-123 në një sfidë spektakolare të zhvilluar në "Barclays Center" të New York-ut ndaj Brooklyn Netsit. Të katër setet e kësaj sfide ishin mjaft të ekuilibruara, me Wizardsi që fitoi të parin me një pikë diferencë dhe të tretin me dy pikë diferencë, ndërsa Brooklyn fitoi vetëm setin e dytë me dy pikë diferencë dhe pjesa e fundit përfundoi në barazim. Kyrie Irving dhe Kevin Durant zhvilluan një ndeshje mjaft të mirë për Brooklyn Netsin, duke regjistruar 58 pikë, 16 rikuperime dhe 17 asistime të dy së bashku, ndërsa për Washington Wizardsin shkëlqeu Bradley Beal me 27 pikë, 10 rikuperime dhe 5 asistime. Kampioni në fuqi i NBA-së, Los Angeles Lakers, mori fitoren e tretë radhazi dhe njëkohësisht të pestën sezonale, pasi ia doli të triumfojë pa shumë mundim në transfertën ndaj Memphis Grizzliesit me rezultatin 94-108. Në "FedExForum" të Memphisit vendasit e nisën shumë vrullshëm ndeshjen dhe në fund



të fraksionit të parë kryesonin me 11 pikë diferencë, por më pas Lakersi mori gjithçka nën kontroll dhe fitoi pjesën e dytë e të katërt me rezultat të thellë, duke siguruar edhe triumfin në të gjithë takimin. LeBron James ishte në një formë të jashtëzakonshme mbrëmjen e djeshme, teksa shënoi 22 pikë, rikuperoi 13 topa në tabelë dhe dha 8 asistime, ndërsa një ndeshje mjaft të mirë bëri edhe ylli tjetër i skuadrës kaliforniane, Kevin Durant. Ylli 32-vjeçar i basketbollit amerikan, Stephen Curry, ishte magjik mbrëmjen e djeshme në "Chase Center" të San Franciscos, pasi shënoi plot 62 pikë, rikuperoi 5 topa dhe dha

4 asistime, duke vulosur i vetëm fitoren 137-122 të Golden State Warriors ndaj Portland Trail Blazersit. Warriorsi mori kështu fitoren e tretë sezonale, në një ndeshje të dominuar që nga fillimi deri në fund, ndërsa Lillard dhe McCollumi të Trail Blazersit u eklipsua nga shkëlqimi i Curryt, duke mos arritur të bëjnë asgjë në parket. Në sfidat e tjera Los Angeles Clipsepsit triumfoi me shifrat 107-12 në transfertën ndaj Phoenix Sunsit, Denver Nuggetsit mposhti Minnesota Timberwolvesit me rezultatin 124-109, ndërsa Chicago Bullsit fitoi me rezultatin 118-108 ndaj Dallas Mavericksit.

SHKURT

Lampardi: Shkarkimi nuk më shqetëson

Chelsea është duke kaluar nëpër një krizë të rezultateve, kurse trajneri Frank Lampard nuk është i shqetësuar se mund të shkarkohet nga detyra e trajnerit. Chelsea të dielën në "Stamford Bridge" pësoi humbje 1-3 nga Manchester City. "Nuk jam i shqetësuar për këtë. Kam pritur se do të kemi periudha të vështira këtë vit. E thashë këtë kur fituam kundër Leedsit kur të gjithë na vlerësonin si kandidat për titull. Nuk ka rëndësi se a jam nën presion apo jo. Sepse para një muaji të gjithë më pyesnin se kur do ta nënshkruaja zgjatjen e kontratës dhe tani njerëzit po flasin për shkarkimin menjëherë, në një periudhë të vështirë ne i humbëm katër ndeshje. Presioni mbetet i vazhdueshëm në një punë si kjo dhe unë kam qenë i vetëdijshëm për këtë", ka thënë Lampardi.

Vdes në aksident futbollisti i Bilbaos

Një aksident i rëndë i ka marrë jetën në moshën 23-vjeçare futbollistit të Athletic Bilbaos, Aitor Gandiaga. Për të përfituar minuta dhe për t'u rritur, drejtuesit e klubit të La Ligës e kishin huazuar sulmuesin te Gernika në Tercera Division. Vetura me të cilën udhëtonte futbollisti u përplas me një autobus, duke shkaktuar vdekjen e menjëhershme të sulmuesit. Lajmi është konfirmuar edhe nga klubi bask nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare. "Dhimbje e madhe për humbjen e djaloshtit tonë. Përqafime të mëdha për familjen, miqtë dhe kolegët e tij", shkruan në "Twitter" klubi iberik.

Pirlo konfirmon interesimin e Joves për Giroudit

Trajneri i Juventusit, Andrea Pirlo, ka konfirmuar se "Zonja e Vjetër" është e interesuar për sulmuesin e Chelsea, Olivier Giroud. "Giroud? Ne mund ta përdorim atë, por këto janë gjëra që drejtori sportiv i Juventusit, Fabio Paratici i di më mirë se unë. Ne biseduam për këtë, por le të shohim nëse do të bëjmë diçka në ditët e ardhshme", ka thënë Pirlo.

Marcelino emërohet trajner i Bilbaos

Tashmë është zyrtarë, Marcelino është trajneri më i ri i Athletic Bilbao. Ish-trajneri i Villarrealit dhe Valencias emërohet "timonieri" më i ri i skuadrës bask pas shkarkimit të teknikut Gaitzka Garitano pavarësisht fitores ndaj Elches 1-0 në La Liga. Marcelino ka firmosur një kontratë deri në qershor të 2022-s.

Fury, Joshuas: Gënjeshtar, ti s'je në gjendje t'ia heqësh kokën askujt

Tyson Fury thotë se kërcënimi i Anthony Joshuas për fitore me nokaut ndaj tij, është thjesht gënjeshtër dhe beson se rivalit të tij britanik i mungon vetëbesimi për ta fituar titullin e botës kundër tij. Kampioni i botës në WBC Fury do të përballet me Joshuan, i cili i mban titujt e tjerë të botës WBA, IBF dhe WBO, për kampionin e padiskutueshëm të botës në kategorinë e rëndë. Joshua fitoi me nokaut dramatik kundër Kubrat Pulev në dhjetor dhe e paralajmëroi Furyn se do t'ia heqë kokën kur të takohen në ring. Por Furyt nuk i bëjnë përshtypje kërcënimet e bashkatdhetarit të vet. "Kjo luftë ka kohë të gjatë që është duke u përgatitur. Ata më kanë shmangur mua që një kohë të gjatë dhe tani do të ndodhë më në fund. Ata ose heqin dorë nga lufta dhe tregojnë publikisht, ose pranojnë të luftojnë. Ata janë humbës në çdo mënyrë", ka thënë Fury. Në lidhje me kërcënimin e Joshuas, Fury ka shtuar: "Është thënie e mirë. Nuk nënkupton asgjë. Njerëzit thonë shumë gjëra, por nuk i realizojnë kur të vijë koha, prandaj e shohim. Kurrë nuk e kam parë atë duke ia hequr kokën dikujt në 22 luftërat e tij deri tani. Është gënjeshtër. Një tjetër gënjeshtër".

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



9 789951 780377




AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLowski

AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4.99 €




9 789951 780100

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN


novelë





Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Fatos Gashi shpalle të pavlefshme diplomën e SHMLM "Dr. Xheladin Deda".

► Kaltrina Jashari shpalle të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Harun Beka".

► "Berlin Chemia/A. Menarini Kosovo" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811159442.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

